

Shefqet Deliallisi

Lef Nosi u pushkatua, Shefqet Daiu, Sami Vrioni, Qazim Kokoshi vdiqën në burg, Bedri Pejani ju dorëzua serbëve, të cilët e pushkatuan.

Të tjerë, Mit' hat Frashëri, Dervish Biçaku, Dhimitër Berati, Eqerem Vlora, Mustafa Kruja, Rexhep Mitrovica, që për t'i shpëtuar persekutimit komunist emigruan, u shpallën kriminelë lufte.

Por dhe ata që kishin vdekur vite më parë, u fshinë nga historia. Të afërmit e tyre ju nënshtruan një persekutimi të paparë. Nuk u kursyen as djemtë e Ismail Qemalit, njëri u burgos dhe u detyrua të ndërronte mbiemrin, tjetri u detyrua të largohet nga Shqipëria, as djali i Aqif Pashës Elbasanit, që u burgos e më pas u poshtërua duke u detyruar nga komunistët të pastronte WC publike të Elbasanit, as djali i Isa Boletinit, që u vra me atentat nga komunistët. Kështu me radhë pothuaj të gjithë, Ymer Deliallisit komunistët i vranë dy djemtë, tre vëllezërit dhe tre djemtë e tyre....

Shkaku del qartë në dokumentet publikuar së fundi. Ja çfarë urdhëronte Enver Hoxha në 17 nëntor 1944 : ".....kapni, arrestoni, dhe ekzekutoni njerëz me ndikim që të bëhen shembull për të tjerët. Këto bëjnë përshtypje në popull."

Ndërsa më vonë një nga krerët komunistë, Gogo Nushi, rrëfëhet për krimet : "Të gjithë ata që kanë qenë kundërshtarë të politikës sonë, jo kriminelë dhe jo kuislingë, ne i konsideronim armiq dhe përpiqeshim t'i zhdukim nga faqja e dheut....asnjë s'meritonte të vritej."



